

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8438, DATË 28.12.1998, “PËR TATIMIN MBI TË ARDHURAT”, TË NDRYSHUAR”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar” është pjesë e paketës fiskale 2020.

Ky projektligj synon:

- incentivimin e sektorit të industrisë automotive duke caktuar normën e tatim fitimit 5% për personat juridikë që ushtrojnë veprimtari ekonomike në këtë industri;
- promovimin e sportit me qëllim rritjen e impaktit pozitiv të tij në shoqëri. Për personat juridikë, të cilët realizojnë fitim vjetor të tatueshëm mbi 100 milionë lekë, shumat e sponsorizuara në fushën e sportit, të njohura si shpenzime të zbritshme, për efekt të llogaritjes së tatimit mbi fitimin, janë të zbritshme sa trefishi i shumës së sponsorizuar;
- mbartjen e humbjeve për një periudhë 5-vjeçare për tatimpaguesit, që investojnë në projekte biznesi, me vlerë mbi 1 miliard lekë;
- trajtimin tatimor për tatimin e të ardhurave nga punësimi në të njëjtën mënyrë për të gjithë individët, që kanë të ardhura nga paga nga më shumë se një burim;
- harmonizimin e ligjit nr.8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, me dispozitat e ligjit për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit, që do të paraqitet për miratim në Kuvend.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky projektligj është parashikuar në programin analitik të projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2019.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Industria automotive në Shqipëri është në fillosat e saj dhe aktualisht has vështirësi të konkurrojë me kushtet, kapacitetet dhe potencialin e ofruar nga vendet e rajonit për këtë lloj industrie.

Duke qenë se vendet e rajonit, si Serbia apo Maqedonia kanë kulturë dhe industri të kësaj natyre më të hershme, thjesht e kanë vazhduar dhe plotësuar më tej duke përmirësuar nivelin e ekspertizës dhe *know-how*. Në këto kushte, propozimi i incentivave fiskale në fushën e industrisë automotive ka qëllim jo vetëm të ndihmojë vendin tonë që të konkurrojë në këtë sektor me vendet e rajonit, por dhe të mundësojë tërheqjen e investimeve në këtë industri.

Gjithashtu, nxitja e investimeve në sektorin e industrisë automotive do të kontribuojë edhe në rritjen e numrit të bizneseve që operojnë në këtë fushë, si dhe hapjen e vendeve të reja të punës.

Praktika ndërkombëtare njih disa forma të incentivimit për sektorë të caktuar të industrisë, për të cilët gjykohet me rëndësi rritja dhe zhvillimi. Konkretisht, këto incentiva mund të konsistojnë p.sh në lehtësi tatimore për fitimin e realizuar nga shoqëritë që operojnë në këta sektorë apo dhe në njohje përtej normës së lejuar të shpenzimeve të zbritshme për efekt fiskal.

Nëpërmjet këtij projektligji propozohet forma e reduktimit të tatimit nga shkalla normale, duke synuar krijimin e kushteve të favorshme për përmirësimin e klimës për zhvillimin e tregut të industrisë automotive brenda vendit.

Një nga efektet e pritshme të këtij projektligji është dhe përmirësimi i situatës në fushën e sportit nëpërmjet lehtësirave të parashikuara. Në këtë kuadër, incentiva që propozohet është për personat juridikë, të cilët realizojnë fitim vjetor të tatueshëm mbi 100 milionë lekë, në lidhje me shumën e sponsorizuara në fushën e sportit, të njohura si shpenzime të zbritshme, të cilat për efekt të llogaritjes së tatimit mbi fitimin e periudhës tatimore, janë të zbritshme sa trefishi i vlerës së shumës së sponsorizuar.

Parashikimi që për tatimpaguesit, të cilët investojnë në projekte biznesi mbi 1 miliard lekë, mbartja e humbjeve të bëhet për një periudhë 5-vjeçare, propozohet pasi këto investime me vlera të konsiderueshme dhe që përgjithësisht kanë një shtrirje të konsiderueshme në kohë, të kenë mundësi që humbjet e rezultuara t'i mbulojnë me fitimet në pesë periudhat e ardhshme tatimore, sipas parimit "*humbja e parë më përpara se ajo e fundit.*"

Sikurse rezulton aktualisht, p.sh. individët e dy apo trepunësuar me paga nën 30 000 lekë nuk janë subjekt i tatimit mbi të ardhurat personale, pasi të ardhurat

nga punësimi deri në 30 000 lekë nuk tatonen. Ndërkohë të ardhurat totale reale të tyre duke qenë se janë nga disa burime janë mbi këtë nivel. Për të pasur trajtim të njëjtë tatimor ndërmjet individëve që i sigurojnë të njëjtën vlerë të ardhurash nga disa burime punësimi me ata që i sigurojnë vetëm nga një burim punësimi, propozohet që të jenë objekte të tatimit mbi të ardhurat nga punësimi të dyja kategoritë e individëve, duke dorëzuar deklaratë individuale vjetore të ardhurash edhe nëse realizimi i të ardhurave individuale vjetore është më i vogël se 2 milionë lekë.

Referuar të dhënave, numri i individëve që kanë deklaruar DIVA (deklarata individuale vjetore e të ardhurave) për vitin 2018 është 9 615, ndërkohë që numri i punëmarrësve që janë të punësuar në më shumë se një vend pune për vitin 2018 është 31 737 dhe për 9-mujorin e vitit 2019 është 35 558.

Ky projektligj synon gjithashtu harmonizimin e ligjit nr.8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, me dispozitat e ligjit për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit, që do të paraqitet për miratim në Kuvend.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji është mbështetur në nenet 78, 83, pika 1, dhe 155, të Kushtetutës.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Projektligji nuk synon përafrimin me legjislacionin komunitar.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Neni 1 parashikon se për sa i përket përjashtimit nga detyrimi për plotësimin dhe dorëzimin e deklaratës individuale vjetore të të ardhurave për të gjithë individët që realizojnë të ardhura bruto vjetore nga të gjitha burimet në shumën e përgjithshme më pak se 2 000 000 (dy milionë) lekë, propozohet të mos zbatohet për individët të cilët janë të punësuar në më shumë se një punëmarrës. Këta individë deklarojnë në deklaratën e tyre vjetore të të ardhurave, në një shumë të vetme, të gjitha të ardhurat e siguruara nga punësimi, llogarisin shumën totale të detyrimit tatimor mbi pagat, zbresin kur është rasti, tatimin e mbajtur në burim nga punëdhënësi dhe përcaktojnë shumën e detyrimit tatimor që duhet të paguajnë për buxhetin e shtetit.

Neni 2 parashikon zëvendësimin e fjalëve “... *fatura tatimore me TVSH, fatura e thjeshtë tatimore* ...” me “... *faturë, e cila është lëshuar në përputhje me ligjin “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”...*”, me qëllim

harmonizimin e dispozitës me ligjin për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit.

Neni 3 është riformulim dhe parashikon se për personat juridikë, të cilët realizojnë fitim vjetor të tatueshëm mbi 100 milionë lekë, shumat e sponsorizuara të njohura si shpenzime të zbritshme, për veprimtaritë e ekipeve sportive, pjesë të federatave sportive të njohura nga legjislacioni në fuqi i fushës, për efekte të përlogaritjes së tatimit mbi fitimin e periudhës tatimore, janë të zbritshme sa trefishi i vlerës së shumës së sponsorizuar. Nuk lejohet mbartja e tyre në periudhat tatimore të ardhshme.

Neni 4 parashikon se për tatimpaguesit, të cilët investojnë në projekte biznesi mbi 1 miliard lekë, në rast se fitimi i tatueshëm në një periudhë tatimore rezulton negativ, humbjet e rezultuara mund të mbulohen me fitimet në pesë periudhat e ardhshme tatimore, sipas parimit "humbja e parë më përpara se ajo e fundit".

Neni 5 parashikon se për personat juridikë të cilët ushtrojnë aktivitet në industrinë automotive, shkalla e tatimit mbi fitimin është 5%.

Këshilli i Ministrave përcakton, me vendim, aktivitetet dhe procedurat për zbatimin e kësaj dispozite.

Neni 6 parashikon se ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në "Fletoren zyrtare" dhe i fillon efektet nga data 1 janar 2020, me përjashtim të nenit 2, të këtij ligji, i cili hyn në fuqi dhe zbatohet sipas afateve të përcaktuara në ligjin për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E KËTIJ PROJEKTAKTI

Për zbatimin e këtij projektligji ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

VIII. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Ky projektligj parashikohet të sjellë efekte në buxhet, të cilat paraprakisht nuk mund të jenë të matshme për shkak të natyrës së ndryshimeve ligjore.

KËSHILLI I MINISTRAVE